

## STATUTI

### I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"Easy Exchange" SH.P.K.

Sot, më datë 08.03.2023, Ortakët e shoqërisë "Easy Exchange" SH.P.K., **Eduart Brihmani dhe Amer Ziko**, bazuar në vullnetin e tyre të lirë themeluan shoqërinë "Easy Exchange" SH.P.K në përputhje me Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, dhe vendosën të hartojnë këtë statut për funksionimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "Easy Exchange" SH.P.K

#### KREU I

##### THEMELIMI, EMRI, KOHËZGJATJA, SELIA

###### Neni 1

###### Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më 08.03.2023 ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "Easy Exchange" SH.P.K.

Themeluesit e shoqërisë janë:

**Z. Eduart Brihmani**, atësia: Ismet, i datëlindjes 27.07.1995, mbajtës i pasaporte me numër: BG8647392 dhe Numër Personal: J50727085N, lindur në Tirane dhe banues nëTiranë, Njësia Administrative Nr.1, Rruga "Agush Gjergjevic", Ndërtesa Nr.2/3, H. 1 , Kodi postar 1004.

**Z. Amer Ziko**, atësia: Ylli, i datëlindjes 04.10.1995, mbajtës i dokumentit karte identiteti me numër: 033667918 dhe Numër Personal: J51004066L, lindur në Tirane dhe banues në Tiranë, Njësia Administrative Nr.4, Rruga "Myslym Keta", Nd.248; H.0; Ap.0, Kodi postar 0000.

###### Neni 2

###### Selia

Selia juridike e Shoqërisë, ndodhet në Tiranë, Njësia Administrative Nr.1, Rruga "Ali Demi", Zona Kadastrale 8150, Pasuria Nr. 7/203+1-1; Volumi 10, Faqe 152.

Shoqëria me miratimin e organeve kompetente, mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.

###### Neni 3

###### Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar.

**Neni 4  
Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Kembim Valutor.

**KREU II  
KAPITALI  
Neni 5  
Kapitali themeltar**

Kapitali fillestar i shoqërisë është 2 500 000 (dy million e pesëqind mijë) lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre.

Ortakët themelues janë:

**Z. Eduart Brihmani**, zotërues i 1(një) kuote të kapitalit, me vlerë 1 250 000 (nje million e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

**Z. Amer Ziko**, zotërues i 1(një) kuote të kapitalit, me vlerë 1 250 000 (nje million e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

**Neni 6**

**Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit të


një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast, shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin

themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet nga Asambleja e Ortakëve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i kapitalit i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

**Neni 7  
Transferimi i kapitalit**



2

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund

të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakeve përderisa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### KREU III

#### ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

##### Neni 8

##### Organi Vendimarrës

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është organi vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimin e statutit
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të këtij neni
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund te veprojnë si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

#### **Neni 9**

#### **Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme e Ortakëve**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet me shkrese ose mesazh elektronik, duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes, rendin e dites dhe t'u dergohet te gjithe ortakeve jo me vone se para 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur, asambleja e pergjithshme e ortakeve nuk eshte thirrur sipas kesaj menyre, ajo mund te marre njoftime te vlefshme vetem nese te gjithe ortakët jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

#### **Neni 10**

#### **Kuorumi**

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme e ortakeve mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortakët me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 20 % te kuotave. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje , te cilat kerkojne shumice te kualifikuar, sipas nenit 87 Te Ligjit "Per tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortakët qe zoterojne me shume se gjysma e numrit total te votave jane te pranishem personalisht , votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te Nenit 88 te ligjit sipermendur.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorunit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

#### **Neni 11**

#### **Marrja e Vendimeve**

Asambleja e pergjithshme e Ortakeve, vendos me tre te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera, si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;

- c) emërimin dhe shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shperblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB-se për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

## Neni 12

### Përgjashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtroje të drejtën e votes nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padije ndaj tij nga shoqëria;
- d) dhenien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një i përfaqësuar i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu siç është dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## Neni 13

### Administrimi

Administrator i shoqërisë emërohet:


**Z. Eduart Brihmani**, atësia: Ismet, i datëlindjes 27.07.1995, mbajtës i pasaporte me numër: BG8647392 dhe Numër Personal: J50727085N, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, Njësia Administrative Nr.1, Rruga "Agush Gjergjeviç", Ndërtesa Nr.2/3, H. 1, Kodi postar 1004.

**Z. Eduart Brihmani**, emërohet në këtë detyrë për një periudhë 5 vjetore, me të drejtë ripërtëritje.

Emer Mbiemer

EDUART BRIHMANI

Nënshkrimi

  
\_\_\_\_\_

Administratori i shoqërisë mund të emërohet edhe një person i tretë jashtë ortakerisë.

 5

## Neni 14

### Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet:

- a) te kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e pergjithshme ;
- b) te përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) te kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) te përgatisin dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së pergjithshme për miratim;
- d) te krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- e) te kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- f) te raportojë përpara asamblesë së pergjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- g) te kryejë detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtezakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.


Nese Asambleja e Pergjithshme emerone me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoje administratorin e shoqerise ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

## Neni 15

### Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.



Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - d) jep kredi.

#### KREU IV

#### VITI FINANCIAR- EKSPERTËT

#### Neni 16 Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar, fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, miraton Llogaritë vjetore të paraqitura nga Administratori, vendos për krijimin e fondit rezerve, fondeve për investime, si dhe destinime të tjera të fitimit ose humbjes së vitit ushtrimor.

#### **Neni 17**

#### **Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë. i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor, si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtes vendimore që ka.

### **KREU V**

#### **PRISHJA – RIORGANIZMI I SHOQËRISË**

#### **Neni 18**

#### **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese së Ortakëve
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këto rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.



## Neni 19

### Riorganizimi i shoqërisë: Bashkimi - Ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të Mbledhjes së përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2012 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

## Neni 20

### Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këto statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

## Neni 21

### Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.


## ORTAKËT

### E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"Easy Exchange"

Eduart BRIHMANI

EDUART BRIHMANI



Amer ZIKO

AMER ZIKO

